

## MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndaj të njëjtin mendim me shumicën e trupit gjykues, për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit Manjola Bejleri, gjyqtare në Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Tiranë, paraqes argumentet për qëndrimin tim në pakicë si vijon:

### **1. Lidhur me depozitën bankare në shumën 38,899.08 euro, në “Alpha Bank”**

Lidhur me të ardhurat e përfituara nga babai i subjektit si burimi fillestar i krijimit, të ardhura të cilat janë përjashtuar nga analiza financiare nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se:

Referuar deklarimeve periodike të subjektit rezulton se në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar të ardhura në shumën 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë, pas ndarjes nga jeta të babait në datën 18.6.2012 dhe, gjithashtu, në DPV-në e vitit 2013 deklaroi çelje depozite në vlerën 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë në “Credins Bank” me burim: *“Trashëgimia e përfituar pas vdekjes së babait tim, U. B., në datën 18.6.2012, deklaruar vitin e kaluar”*.

Pika 5, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, i ka njohur vlerën e provës deklaratorë së pasurisë në vitet 2012 dhe 2013, prandaj dhe këto deklarata vërtetojnë pretendimin e subjektit në proces dhe kanë rëndësi provuese, lidhur me përfitimin e kësaj shume të disponuar *cash* nga i ndjeri babai i subjektit.

Referuar ligjshmërisë së krijimit të shumës 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë, nga babai gjatë hetimit administrativ, rezultoi e provuar, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, mundësia financiare e babait të subjektit për të disponuar me burime të ligjshme shumën e pretenduar për sa u provua se ka pasur të ardhura të ligjshme në shumën 11,006,939 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë) lekë dhe nga hetimi administrativ nuk rezultoi që ky shtetas përveç shpenzimeve për jetesë edhe shpenzimeve shëndetësore të ketë pasur investime të ndryshme, të cilat do të vinin në dyshim mundësinë e tij për të kursyer vlerën e deklaruar.

Për sa provohet nga deklaratimet periodike të subjektit përfitimi i kësaj shume, si dhe mundësia e krijimit me burime të ligjshme nga babai i subjektit, vlerësoj se nuk mund të ngrihen dyshime mbi përfitimin e kësaj shume prej subjektit të rivlerësimit në vitin 2012.

Pas analizimit të sa më sipër dhe në referim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, arrij në përfundimin se përfitimi i këtyre të ardhurave u provua bindshëm nga subjekti për sa ishte deklaruar rregullisht që në momentin e përfitimit të tyre edhe për sa u provua mundësia financiare e babait të saj për të krijuar këtë shumë me burime të ligjshme dhe, për rrjedhojë, kjo shumë duhej marrë në konsideratë në analizën financiare për krijimin e depozitës bankare.

Nuk jam pajtuar gjithashtu me konkluzionin e shumicës së trupit gjykues, sipas të cilës shpjegimet e subjektit se shuma prej 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) euro është mbajtur *cash* në banesë në vitin 2014 dhe është përdorur si burim për krijimin e depozitës në vitin 2015, nuk janë bindëse dhe ngelen në nivel deklarativ, pasi nuk reflektohet gjendja *cash* në banesë në DPV-në e vitit 2014.

Në vlerësimin tim, arsyetimi lidhur me shumën e tërhequr nga llogaria bankare në shtator të vitit 2014, e cila nuk u deklarua si gjendje *cash* në banesë në DPV-në e vitit 2014, duhet të bëhej duke analizuar edhe në DPV-në e vitit 2015, në të cilën subjekti ka deklaruar në mënyrë të qartë se ridepozitimi i kësaj shume kishte si burim shumën e tërhequr prej saj nga banka në vitin 2014.

Në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, i cili i ka njohur vlerën e provës deklaratorë së pasurisë në vitin 2015, deklarimi i subjektit në vitin 2015 duhej konsideruar si një e dhënë që

vërtetonte pretendimin e subjektit në proces dhe duhej çmuar me rëndësi provuese, në referim të qëndrimeve të mëparshme të mbajtura nga Komisioni, lidhur me korrigjimin e deklarimeve të subjekteve në vitin pasardhës.

Pas analizimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në DPV-të e viteve 2014 dhe 2015 dhe shpjegimeve të subjektit, kam arritur në përfundimin se pavarësisht se subjekti ka pasaktësi në deklarin e likuiditeteve të vitit 2014, mbi gjendjen *cash* të deklaruar në këtë vit, për sa pasaktësia e konstatuar është korrigjuar nga subjekti në deklarin për “burimin” në vitin 2015, ndaj ajo nuk mund të ndikonte në mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e depozitës bankare në shumën 38,899.08 (tridhjetë e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) euro, në “Alpha Bank”,

Në konkluzion të sa më sipër kam arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Manjola Bejleri, ka provuar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj depozite dhe ajo duhej marrë në konsideratë në analizën financiare.

## **2. Lidhur me automjetin në përdorim “Volkswagen Passat”**

Nuk jam pajtuar gjithashtu me konkluzionin e shumicës së trupit gjykues, të Komisionit, e cila krijoi bindjen se ky automjet është pasuri e subjektit të rivlerësimit.

Referuar situatës faktike të përdorimit të automjetit prej subjektit të rivlerësimit, provuar gjatë hetimit në Komision, subjekti ka përmbushur detyrimin për të deklaruar këtë marrëdhënie, në zbatim të përcaktimeve të pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit përcaktohej se: *“Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, ‘Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit”*.

Referuar situatës faktike, lidhur me mundësinë financiare të pronarit të automjetit, vëllait të subjektit z. F. B., rezulton e provuar mundësia financiare e tij lidhur me burimin e ligjshëm të kësaj pasurie në analizë të dokumentacionit ligjor provues referuar në vijim:

- vërtetim datë 24.3.2020, lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, i cili provon se për periudhën e punësimit 1.3.2007 – 29.2.2008, shtetasi F. B. ka përfituar të ardhurat në total (*neto*) në shumën 835,806 (tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtë) lekë;

- dokumentacion bankar provues, i cili provon pagat e derdhura për periudhën 6.8.2008 – dhjetor 2010, se shtetasi F. B. ka punuar koordinator për shitjet pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh. a., si dhe ka përfituar të ardhurat në total (*neto*) në shumën 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;

- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2020, lëshuar nga Fakulteti i \*\*\*, Universiteti i Tiranës, me të cilin provohet se shtetasi F. B., duke filluar nga viti 2010 është personel akademik efektiv me kohë të plotë, me gradën shkencore “doktor”, me pagë *bruto* 96,170 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë/muaj.

Për sa subjekti ka bërë deklarin të saktë në deklaratën *Vetting*, duke e deklaruar përdorimin e këtij automjeti prej saj dhe, për rrjedhojë, nuk e ka fshehur atë, dhe për sa u provua mundësia financiare për pronarin e automjetit, lidhur me burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, vlerësoj se rrethanat e konstatuara gjatë hetimit administrativ janë të pamjaftueshme për të arritur në konkluzionin se ky automjet është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

### **3. Lidhur me depozitimin *cash* në llogarinë në “Raiffeisen Bank”, në datën 2.6.2008**

Nga lëvizjet e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank” rezultoi se në datën 2.6.2008, subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* shumën totale prej 1,636,043 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyzet e tre) lekësh dhe në datën 4.7.2008 e ka tërhequr *cash* këtë shumë. Nuk jam pajtuar gjithashtu me konkluzionin e shumicës së trupit gjykues të Komisionit, sipas të cilit shuma prej 1,636,043 lekësh u konsiderua si shpenzim i subjektit në analizën financiare të vitit 2008.

Subjekti ka shpjeguar se këto të holla, të cilat i ka marrë në atë kohë nga babai U. B., i ka derdhur me të vetmin qëllim për t’u pajisur me vërtetimin përkatës nga banka që kërkohej për marrjen e vizës australiane dhe ka paraqitur si provë edhe vizat e miratuara më 24.6.2008 nga Ambasada Australiane, e cila në atë kohë e kishte zyrën konsullore për Shqipërinë në Athinë, Greqi, duke provuar qëllimin e depozitimit më sipër.

Subjekti ka arritur të provojë dhe të shpjegojë qëllimin e këtij depozitimi referuar veprimin bankar, shërbyer për këtë garanci dhe rikthyer në periudhë tepër të shkurtër kohore, provuar nga transaksioni i kryer, ku u depozitua dhe u tërhoq e njëjta shumë në një kohë të shkurtër dhe paraqitja si prove e vizave të marra po në këtë periudhë me transaksionin, dhe provueshmëria e burimit të të ardhurave të babait vërtetuar nga hetimi administrativ, duhet të passillnin heqjen e kësaj shume si shpenzim në analizën financiare të vitit 2008.

### **4. Lidhur me apartamentin e banimit me sip. 91 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*”**

Ky apartament ka pasur si burim krijimi në vitin 2003:

- i) hua në shumën 12,000 (dymbëdhjetë mijë) USD e marrë nga vëllai A. B., pa afat;
- ii) kredi bankare në shumën 30,000 (tridhjetë mijë) USD.

i) Për sa i përket burimit të parë të krijimit të kësaj pasurie, huas së marrë në vitin 2003 nga vëllai i subjektit A. B., në shumën prej 12,000 (dymbëdhjetë mijë) USD, deklarimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* përputhet me deklarinin e bërë prej saj në DPV-në e vitit 2003, ku, po ashtu, deklarohet se kjo hua nga vëllai, me banim në Sidney, Australi, prej vitit 2000, ka shërbyer si burim krijimi për këtë apartament.

2. Për sa i përket burimit të dytë të krijimit të kësaj pasurie, kredia në shumën 30,000 (tridhjetë mijë) USD, deklaruar si burim krijimi për këtë apartament, nuk janë konstatuar problematika lidhur me të si burim, por barra e provës së kaluar subjektit ka qenë e lidhur me shlyerjen e kësaj kredie bankare në datën 26.2.2007, në vlerën prej 23,105 (njëzet e tre mijë e njëqind e pesë) USD, deklaruar shlyer, ndër të tjera, edhe me huan në vitin 2007, të marrë nga vëllai F. B., në shumën 1,000,000 (një milion) lekë, deklaruar prej saj edhe në DPV-në e vitit 2007.

Duke pasur parasysh që procesi i kontrollit të ligjshmërisë së burimeve dhe të ardhurave në funksion të rivlerësimit kalimtar, parashih si pjesë të pandarë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e krijimit të pasurive, parashikuar në nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, në paragrafët 1 dhe 4 dhe mbi të ardhurat e mësipërme përfituar prej huave nga vëllezërit, subjektit iu ngarkua barra e provës për të provuar ligjshmërinë e krijimit të shumave të dhëna hua prej tyre.

Pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me huat e marra nga subjekti i rivlerësimit prej vëllezërve, përkatësisht prej vëllait A. B. në vitin 2002 në shumën 12,000 (dymbëdhjetë mijë) USD, për blerjen e apartamentit dhe prej vëllait tjetër F. B., në vitin 2007, në vlerën 1,000,000 (një milion) lekë, për shlyerjen e kredisë së marrë për blerjen e këtij apartamenti, shumica e trupit gjykues nuk i ka konsideruar këto hua në analizën financiare.

Në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 32/2 dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016 në vlerësimin e çështjes në tërësi, kam vlersuar subjektin ka arritur të sigurojë gjithë provat e mundshme, mbi të ardhurat e vëllezërve, për periudhën para afro 20-vitesh, dhe në balancë të qëllimit dhe parimeve që drejtojnë procesin e rivlerësimit, përfshirë barrën e provës, barazinë para ligjit, të drejtën për një proces të rregullt dhe interesin publik, në rastin konkret, analiza e mundësive huadhënëse të personave të tjerë të lidhur të subjektit me të ardhura të ligjshme, u arrit të provohej në nivel të mjaftueshëm për vlerat 12,000 (dymbëdhjetë mijë) USD dhe 1,000,000 (një milion) lekë.

Nga sa më sipër, duke marrë në konsideratë në analizën financiare vlerat e huave të marra nga vëllezërit e subjektit, arsyetuar më sipër, analiza financiare e subjektit të rivlerësimit Manjola Bejleri, për blerjen e apartamentit, do të rezultonte në vlera pozitive, ndërsa analiza financiare, për shlyerjen e kredisë në datën 26.2.2007, për sa të ardhurat e përfituara prej saj nga kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 20.11.2007, janë përfituar pas shlyerjes së kredisë dhe, për rrjedhojë, nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare për mundësinë e subjektit për shlyerjen e kredisë bankare, do të rezultonte mungesa e likuiditeteve në vlerën 494,418 lekë, e cila nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit.

### **5. Lidhur me analizën financiare për periudhën 2003 – 2016**

Për sa i përket analizës financiare: sipas arsytimit ligjor konsiderimi në të i huave në vitin 2002, në shumën 12,000 (dymbëdhjetë mijë) USD, nga vëllai A. B. dhe në shumën 1,000,000 (një milion) lekë nga vëllai F. B., në shkurt të vitit 2007; konsiderimi i shumës 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë, përfituar nga babai në vitin 2012 dhe moskonsiderimi si shpenzim i shumës 1,636,043 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyzet e tre) lekë në vitin 2008; pasqyrimi i vlerave të likuiditeteve, ndër vite, në llogarinë në dollar, në “Raiffeisen Bank”,; korrigjimi i shlyerjeve të huamarrjes ndaj vëllait F. B., në shumën 800,000 (tetëqind mijë) lekë, jo si e krijuar e gjitha në vitin 2011, por prej vitin 2009, do të sillte si konkluzion një rezultat final financiar negativ pas analizës financiare të përditësuar, prej afro 1,000,000 (një milion) lekë, për gjithë periudhën e deklaramit, e cila nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit, dhe për vetë faktin se analiza financiare është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson.

Nga rrethanat e faktit dhe të dhënat e hetimit administrativ, analizuar së bashku me shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, kam arritur në konkluzionin se znj. Manjola Bejleri nuk ndodhet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 61/3 i ligjit nr. 84/2016 dhe niveli i konstatimeve të marra në tërësinë e tyre nuk plotësojnë kriteret dhe shkaqet që përlligjin marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të saj, ndaj në zbatim të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, kam votuar për konfirmimin e saj në detyrë.

**KRYESUESE (kundër)**

**Xhensila PINE**